



**Policia e
Kosovës**



RAPORTI VJETOR 2025

**Raporti vjetor i
punës së Policisë
së Kosovës
Janar-dhjetor
2025**



Policia e Kosovës

Tel: 192 ose +383 38 550 999
Faqja zyrtare: www.kosovopolice.com
Email: info@kosovopolice.com
Rrjetet sociale:
• Facebook: [KosovoPolice](https://www.facebook.com/KosovoPolice)
• Twitter: [@Kosovo_Police](https://twitter.com/Kosovo_Police)
• Aplikacioni: Lajmëro Policinë (për raportimin e rasteve)

POLICIA E KOSOVËS

Titulli i raportit:	Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës Janar - Dhjetor 2025
Përpiluesi:	Toger Fahrrije LUTFIU Shef i Sektorit Qendror për Statistikë dhe Analizë Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
Mbikëqyrur nga:	Kolonel Riza SHILLOVA Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
Raporti është aprovuar nga:	Kolonel Fehmi HOTI Zëvendësdyrejtor i Përgjithshëm i Policisë Kolonel Gazmend HOXHA Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës
Dizajni grafik:	Çajup KAJTAZI Njësia për Dizajn dhe Mirëmbajtje të Web-faqes - Intranet Drejtoria për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës
Lektor:	Leonora Fejzullahu - Rruhani Drejtorja për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
Përkthim në gjuhën angleze dhe serbe:	Sektori i përkthimeve Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Sektori Qendror për Statistikë dhe Analizë
Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
Policia e Republikës së Kosovës



Policia e Republikës së Kosovës

www.kosovopolice.com
www.facebook.com/KosovoPolice
twitter.com/Kosovo_Police
info@kosovopolice.com
Aplikacioni lajmëro Policinë

PËRMBAJTJA

- Lista e shkurtesave, 4
- Mesazhi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, 5
- Përmbledhje ekzekutive, 6
- Siguria, rendi dhe qetësia publike, 8
- Siguria në trafikun rrugor, 12
- Policimi në Bashkësi, 14
- Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, 14
- Kontrolli, mbikëqyrja dhe menaxhimi i integruar i kufirit, 17
- Burimet njerëzore, 20
- Shërbimet mbështetëse, 23
- Disiplina dhe kontrolli i brendshëm, 24
- Bashkëpunimi me publikun – mediat, 26
- Sfidat e Policisë, 27
- Objektivat strategjike për vitin 2025, 27
- Prioritetet për vitin 2025, 27

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORUARA NË TEKSTIN E RAPORTIT VJETOR

- BQK
- Banka Qendrore e Kosovës
- DBNP
- Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Policor
- DHKEK
- Drejtoria e Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit
- DHTN
- Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë
- DHKOKR
- Drejtoria e Hetimit të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
- DIA
- Departamenti i Inteligjencës dhe Analizës
- DRP
- Drejtoria Rajonale e Policisë
- DMA
- Drejtoria për Mbrojtje të Afërt
- DNJS
- Departamenti i Njësive Speciale
- DPK
- Departamenti i Kufirit
- DSHSH
- Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore
- EUROPOL
- Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit
- I-Baza
- Databazë e Inteligjencës
- FAST
- Ekipi për kërkim aktiv të të arrestuarve
- MIK
- Menaxhimi i Integruar i Kufirit
- NJHR
- Njësia e Hetimeve Rajonale
- PK
- Policia e Kosovës
- QNJS
- Qendra e Njësive Speciale
- RKS
- Republika e Kosovës
- RTK
- Radiotelevizioni i Kosovës
- VIP
- Persona të rëndësishëm

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË



Kolonel Gazmend HOXHA

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës

Viti 2025 ka qenë një vit sfidues, por njëkohësisht dëshmuar i përkushtimit, profesionalizmit dhe përgjegjësisë së Policisë së Kosovës në përmbushjen e mandatit të saj kushtetues dhe ligjor për ruajtjen e rendit, sigurisë publike dhe sundimit të ligjit.

Gjatë këtij viti, Policia e Kosovës ka arritur rezultate të rëndësishme në parandalimin dhe luftimin e krimit, forcimin e bashkëpunimit me qytetarët, avancimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe thellimin e partneritetit ndërkombëtar. Pavarësisht rritjes së përgjithshme të numrit të rasteve të trajtuara, është shënuar rënie e veprave penale në disa kategori të ndjeshme, duke reflektuar efektivitetin e masave operative dhe preventive të zbatuara.

Angazhimi intensiv policor ka rezultuar me rritje të arrestimeve, konfiskime të konsiderueshme të armëve, municionit dhe substancave narkotike, si dhe goditje të drejtpërdrejta ndaj krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, narkotikëve dhe formave të tjera të kriminalitetit të rëndë. Një fokus i veçantë i është kushtuar parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe krimeve kibernetike, duke garantuar një qasje proaktive dhe të bazuar në inteligjencë.

Siguria në trafikun rrugor ka mbetur prioritet strategjik, ku përkundër intensifikimit të masave policore dhe aktiviteteve vetëdijesuese, statistikave dhe aksidenteve tregojnë nevojën për angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim më të gjerë institucional dhe shoqëror për mbrojtjen e jetës së qytetarëve.

Policia e Kosovës ka vazhduar të ndërtojë marrëdhënie të qëndrueshme me komunitetin përmes policimit në bashkësi, duke rritur besimin publik, transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet e sigurisë. Po ashtu, është avancuar ndjeshëm bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i informatave përmes mekanizmave evropianë dhe ndërkombëtarë të sigurisë.

Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi profesional, mirëqenia e zyrtarëve policorë, forcimi i disiplinës dhe kontrollit të brendshëm, si dhe investimet në teknologji, logjistikë dhe infrastrukturë, kanë qenë shtylla kryesore për ndërtimin e një policie moderne, profesionale dhe të besueshme.

Falë përkushtimit të zyrtarëve policorë dhe stafit civil, si dhe mbështetjes së partnerëve tanë vendorë dhe ndërkombëtarë, Policia e Kosovës ka arritur të realizojë objektivat strategjike për vitin 2025 dhe të mbetet një institucion kyç në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit të vendit.

Në emër të Policisë së Kosovës, shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë zyrtarët policorë për punën e palodhur dhe sakrificën e tyre, si dhe për qytetarët për bashkëpunimin dhe besimin e vazhdueshëm. Ne mbetemi të përkushtuar që edhe në të ardhmen të shërbejmë me integritet, profesionalizëm dhe përgjegjësi ndaj Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Policinë e Kosovës janë të punësuar 9,871 punonjës, prej të cilëve 9,037 janë zyrtarë policorë, ndërsa 834 staf civil. 84.78% e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 15.22% gjinisë femërore, prej të cilëve 90.10% janë shqiptarë, ndërsa 9.90% iu takojnë komuniteteve të tjera.

- Numri i vrasjeve ka shënuar ngritje për 11.76%;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar ngritje për 3.66%;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie, për 3.73%;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar rënie, për 1.49%.

- Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm të Policisë së Kosovës për rritjen e sigurisë në trafikun rrugor, dhe në vazhdimësi të aktiviteteve kryesore të realizuara gjatë kësaj periudhe, janë zbatuar 68 urdhra/plane/task forcë me fokus parandalimin e aksidenteve, rritjen e kontrollit policor dhe ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve në trafik.

Policia e Kosovës i kushton rëndësi të veçantë mirëqenies fizike dhe mendore të zyrtarëve të saj, duke e konsideruar atë thelbësore për ruajtjen e gatishmërisë operative dhe sigurisë në punë. Gjatë vitit raportues, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore janë realizuar aktivitete të shumta në fushën e ekzaminimeve mjekësore e psikologjike, përkrahjes shëndetësore dhe menaxhimit të lëndimeve e sëmundjeve në detyrë.

Në bashkëpunim me Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut është zhvilluar kampanja e dhurimit të gjakut me 1,419 dhurues, ndërsa ekipi mjekësor ka ofruar 67 asistencë me autoambulancë në kuadër të urdhrave operativë. Po ashtu, janë organizuar ligjërata tematike shëndetësore dhe janë pranuar 11 defibrilatorë profesionalë si donacion nga OSBE-ja.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar qindra ekzaminime mjekësore dhe psikologjike, përfshirë ekzaminime periodike për njësi të ndryshme, ekzaminime për aplikantë të rinj, 714 testime psikologjike dhe 34 rivlerësime psikologjike, duke dëshmuar përkushtimin e vazhdueshëm ndaj shëndetit dhe mirëqenies së personelit policor.

Në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej 1,711 raste. Janë:

- realizuar 316 operacione;
- arrestuar 1,515 persona të dyshuar për vepra të rënda penale, ndërsa janë ndaluar 661 persona;
- bastisur&kontrolluar 867 lokale;
- paraqitur 1,031 kallëzime penale me kryes të njohur, ndaj 1,948 personave; si dhe janë
- goditur 22 grupe kriminale.

- Për të rritur sigurinë në komunitet, në përputhje me Strategjinë e Integruar të Policimit të udhëhequr nga Inteligenca dhe Policimit në Bashkësi, si dhe me Planin e Veprimit 2021–2025, Policia ka vazhduar angazhimin për forcimin e partneritetit me komunitetin. Kjo është realizuar përmes një game të gjerë projektesh dhe aktiviteteve që synojnë parandalimin e krimit dhe promovimin e sigurisë publike.
- Fokus i veçantë i është kushtuar iniciativave ndërgjegjësuese dhe këshilluese, veçanërisht për nxënësit, me qëllim adresimin e fenomeneve negative si abuzimi me drogën, bullizmi dhe dhuna në familje.
- Po ashtu, Policia ka zhvilluar programe të ndryshme komunikimi me komunitetin, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat, organizatat lokale dhe banorët, për trajtimin proaktiv të krimit. Këto përpjekje synojnë ndërtimin e besimit, fuqizimin e komunitetit dhe garantimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë.

Është përmbyllur procesi i rekrutimit për Gjeneratën 62, me nënshkrimin e kontratave dhe fillimin e trajnimit për 283 kandidatë.

Policia e Kosovës ka vazhduar të zhvillojë kapacitetet e zyrtarëve të saj përmes 1,252 aktiviteteve trajnuese me gjithsej 11,829 pjesëmarrës. Fokus i veçantë ka qenë ricertifikimi, trajnimi i specializuar dhe pjesëmarrja në seminare dhe konferenca ndërkombëtare.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë së kufijve, janë ndërmarrë: 65 operacione, 439 patrullime të përbashkëta, janë realizuar 93 aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar, 4,424 refuzime të hyrjes dhe 697 refuzime të daljes nga Republika e Kosovës. Janë shqiptuar 1,029 gjoba për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve.

Në vitin 2025, policia vazhdoi të forconte bashkëpunimin e saj me mediat për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë publike dhe për të nxitur besimin e komunitetit. Janë lëshuar:
-1,964 komunikata me shkrim për media;
-365 raporte 24-orëshe;
-1,669 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Raste

Viti 2024		Viti 2025
48,615	●	50,310



Vepra penale

Viti 2024		Viti 2025
27,865	●	27,038



Persona të arrestuar

Viti 2024		Viti 2025
15,297	●	16,482



Persona të ndaluar

Viti 2024		Viti 2025
6,002	●	5,886



Grupe kriminale të goditura

Viti 2024		Viti 2025
28	●	22



Armë zjarri të konfiskuara

Viti 2024		Viti 2025
1,746	●	1,931



Municione të konfiskuara

Viti 2024		Viti 2025
33,250	●	39,116



Persona të vdekur në trafikun rrugor

Viti 2024		Viti 2025
97	●	111



Tiketa të shqiptuara në trafikun rrugor

Viti 2024		Viti 2025
724,885	●	785,107



Gjopa për kundërvajtje në fushën e migrimit

Viti 2024		Viti 2025
1,054	●	1,029



Aksidente në trafikun rrugor

Viti 2024		Viti 2025
22,604	●	24,150



Hyrje/dalje të personave në kufi

Viti 2024		Viti 2025
30,503,299	●	34,500,561



Protesta dhe tubime të qytetarëve

Viti 2024		Viti 2025
477	●	160



Refuzimi i hyrjes në Republikën e Kosovës

Viti 2024		Viti 2025
3,166	●	4,424



Refuzimi i daljes nga Republika e Kosovës

Viti 2024		Viti 2025
648	●	697

Siguria, rendi dhe qetësia publike

Policia, si institucion i zbatimit të ligjit, ka arritur sukses të konsiderueshëm në parandalimin dhe luftimin e kriminimit si dhe rritjen e bashkëpunimit efektiv me qytetarët, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe partneriteteteve ndërkombëtare. Pavarësisht përballjes me sfida të shumta, Policia mbetet e përkushtuar ndaj rolit të saj në ruajtjen e sigurisë publike, zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e komuniteteve.

Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej **50,310** raste, prej të cilave **27,038** janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa **23,272** raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, numri i rasteve ka shënuar *ngritje* për **3.48%**, ndërsa numri i veprave penale ka shënuar *rënie* për **2.96%**. Numri i kundërvajtjeve dhe raste të natyrave të tjera kanë shënuar *ngritje* për **12.15%**.

Rënie/ngritjet më të dalluara janë vërejtur si në vijim:

- Numri i vrasjeve ka shënuar *ngritje*, nga **17** në **19** ose *ngritje* për **11.76%**;
- Numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar *ngritje*, nga **218** në **226**, ose *ngritje* për **3.66%**;
- Numri i vjedhjeve ka shënuar *rënie*, nga **3,696**, në **3,613**, ose *rënie* për **2.24%**;
- Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar *rënie*, nga **2,168** në **2,087**, ose *rënie* për **3.73%**;
- Numri i grabitjeve ka shënuar *rënie*, nga **72** në **66**, ose *rënie* për **8.33%**;
- Numri i rasteve të dhunës në familje ka shënuar *rënie*, nga **2,547** në **2,509**, ose *rënie* për **1.49%**.

Gjatë kësaj periudhe, si rezultat i angazhimit policor, janë ndaluar **5,886** persona, për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024 është shënuar një *rënie* për **1.93%**. Po ashtu, Policia ka arrestuar **16,482** persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një *ngritje* e personave të arrestuar për **7.74%**.

Në operacione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar **1,931** armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025 është shënuar një *ngritje* për **10.59%**, si dhe janë konfiskuar **39,116** sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025 është shënuar një *ngritje* për **17.64%**.

Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej **160** protesta dhe tubime, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta dhe tubime. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025 vërehet një *rënie* e protestave dhe tubimeve për **66.45%**.

Përveç angazhimit policor në përmbushjen e objektivave strategjike të Policisë të parapara për vitin 2025, gjatë kësaj periudhe, Policia ka ofruar mbështetjen e saj të vazhdueshme dhe autoriteteteve tjera relevante në përmbushjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligj, me ç'rast janë ofruar **7,970** asistime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një *ngritje* e ofrimit të asistencës për **5.10%**.

Departamenti për Inteligjencë dhe Analizë ka mbledhur me sukses të dhëna thelbësore gjatë kësaj periudhe dhe ka shpërndarë raporte gjithëpërfshirëse për njësitë relevante.

Tabela.nr1: Aktivitetet e DIA-s

INTELIGJENCË DHE ANALIZË	2024	2025	%
Informata të intel. të pranuar(5X5X5)	10,689	11,320	5.90
Kërkesa të pranuar ne DIA	2,868	3,456	21.69
Kërkesa të shpërndara nga DIA	2,687	3,270	21.70
Raporti mbi situatën e sigurisë	215	220	2.33
Profile të caktuar/subjektit	204	356	74.51
Vlerësime të rrezikshmërisë	139	170	22.30
Buletini i Inteligjencës	53	52	-1.89
Asistime në terren nga DIA	862	1418	64.50
Regjistrime të rasteve në I-Baza	10,676	14,425	35.12

Mbështetja nga Njësitë Speciale:

Departamenti i Njësitë Speciale ka kryer operacione të shumta mbështetëse krahas njësitë të ndryshme, duke u angazhuar në aktivitete me rrezik të lartë dhe të mesëm që lidhen me krimet e rënda, terrorizmin, mbrojtjen e rendit kushtetues dhe mbrojtjen e përgjithshme të sigurisë.

Tabela nr. 2: Aktivitetet e Departamentit të Njësitë Speciale

Lloji i aktiviteteve operative	Krahasimi sipas viteve		
	2024	2025	%
Urdhra operative	84	81	-3.57
Plane operative	314	339	7.96
Plane taktike	155	85	-45.16
Asistim gjykatave	3	1	-66.66
Asistim SHKK-së	35	126	260
Asistim agjencive tjera (DBNP etj.)	1	1	0
Menaxhimi i protestave	3	5	66.66

Tabela nr. 3: Aktivitetet e Departamentit të Njësitë Speciale

Lloji i aktiviteteve operative	Krahasimi sipas viteve		
	2024	2025	%
Patrullim sigurim në Kampin Vrellë	590	1161	96.77
Punë sekondare BQK	79	129	63.29
Asistim DHKR	7	38	442.85
Asistim DMA-së	12	22	83.33
Asistim DKKO	17	39	129.41
Asistim DKKT	1	7	600
Asistim Policisë Kufitare	3	1	-66.66

Angazhim (Divizioni, Njësia DRP)	576	857	48.78
Gjendje gatishmërie	1041	1463	40.53
Pika statike	129	149	15.5
Subs. narkotike të gjetura	13	26	100
Hapësira dhe rrugë të kontrolluara	1246	1734	39.16
Objekte të kontrolluara	705	928	31.63
Automjete të kontrolluara	14167	15832	11.75
Persona të prangosur	21	45	114.28
Persona të kontrolluar	11332	14849	31.03
Municion i gjetur	40	64	60
Armë të gjetura	13	29	123.07
Gjetje e mjeteve të dyshuara shpërthyesë – neutralizim	40	59	47.5
Hetim pas shpërthimit	21	13	-38.09
Çmontim i mjeteve shpërthyesë	1	0	-100
Angazhimi ndaj kërcënimeve me bombë	2	9	350
Inspektive	168	144	-14.28

Pika kontrolli	2011	2945	46.44
Patrullim në këmbë dhe mobile	1492	2405	61.19
Përcjellje VIP-së	1		-100
Asistim NJHR	1		-100
Asistim DHTN-së	1	5	400
Asistim DHKEK	3	2	-33.33
Asistim DRP Prishtinë	206	484	134.95
Asistim DRP Gjakovë	4	14	250
Asistim DRP Mitrovicë	341	679	99.12
Asistim DRP Pejë	9	319	3444.44
Asistim DRP Prizren	11	21	90.9
Asistim DRP Ferizaj	2	33	1550
Asistim DRP Gjiilan	6	7	16.66
Gjurmim, kërkim i personave të dyshuar ose të humbur	14	19	35.71
Vlerësimi i rrezikshmërisë për personat me rëndësi të veçantë	22	12	-45.45

Tabela nr.4: Aktivitetet e Departamentit të Njësisë Speciale

Aktivitetet operative	Krahasimi sipas viteve		
	2024	2025	%
Rivlerësimi i rrezikshmërisë për personat me rëndësi të veçantë	5	1	-44.44
Vlerësimi i rrezikshmërisë për objektet me rëndësi të veçantë	5	6	66.67
Rivlerësimi i rrezikshmërisë për objektet me rëndësi të veçantë	8	1	100
Vlerësimi i rrezikshmërisë për delegacionet e huaja	26	8	23.81
Vlerësimi i rrezikshmërisë për policë	7	3	600
Vlerësimi i rrezikshmërisë për gazetarë	1	0	100
Vlerësimi i rrezikshmërisë për dëshmitarë të mbrojtur	1	1	-50
Kontaktet 4 mujore lidhur me sigurinë për ambasadat dhe zyrat ndërlidhëse diplomatike të huaja	18	0	500
Vlerësimi i rrezikshmërisë për vendbanimin e dëshmitarëve bashkëpunues	1	1	100
Vlerësimi i rrezikshmërisë për rezidencat e personaliteteve vendore	0	1	100
Operacion i veçantë	68	59	-17.07
Ekstradimi	49	55	-5.77
Operacion rutinë përcjellje e VIP vendorë	20	17	-31.03

Policia e Kosovës vazhdon të mbajë bashkëpunim të fuqishëm ndërkombëtar me shtetet për të rritur efektivitetin e saj në luftimin e krimit, garantimin e sigurisë dhe promovimin e stabilitetit rajonal.

Tabela nr.5: Komunikimi sipas kategorive të autoriteteve/kanaleve zyrtare

Autoriteti/kanali i komunikimit	2024	2025	Ndryshimi	%
NCB-INTERPOL	5007	5847	840	16.77
SIENA-EUROPOL	1658	3236	1578	95.17
Ndërlidhësit tanë policorë jashtë vendit	1112	1263	151	13.57
Ndërlidhësit policorë të huaj	1024	1623	599	58.49
Organizatata ndërkombëtare tjera	8573	5001	-3572	-41.66
Ambasadat e Kosovës jashtë	1209	1536	327	27.04
Ambasadat e huaja në Kosovë	1000	1007	7	0.7
Bashkëpunimi ndërinstitucional brenda	5715	8665	2950	51.61
Policia e Kosovës/DBNP	18228	21675	3447	18.91

Siguria në trafikun rrugor

Siguria në trafikun rrugor paraqet një nga prioritetet kryesore të Policisë dhe mbetet një fushë me rëndësi të veçantë për ruajtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve. Faktorët kryesorë që ndikojnë në sigurinë rrugore përfshijnë tejkalimin e shpejtësisë së lejuar, mosrespektimin e sinjalizimit rrugor, drejtimin e automjeteve në gjendje të shpërqendrimit, si dhe shkeljen e dispozitave të legjislacionit përkatës në fushën e trafikut rrugor.

Policia, në kuadër të mandatit të saj ligjor, ka ndërmarrë masa operative, parandaluese dhe ndëshkuese, përmes zbatimit të planeve operative, aktiviteteve të vetëdijesimit publik, programeve edukative në institucionet arsimore, si dhe përmes bashkëpunimit ndërinstytucional me autoritetet kompetente, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në trafikun rrugor dhe parandalimin e aksidenteve.

Në aspektin e sigurisë operative, aktivitetet janë fokusuar në përcjelljen e materieve të rrezikshme – eksplozivit, ku janë realizuar 602 përcjellje gjatë transferit dhe 92 përcjellje gjatë importit, gjithsej 694 raste, në përputhje me procedurat standarde operative dhe aktet nënligjore në fuqi.

Po ashtu, janë realizuar 459 aktivitete të përcjelljes së personaliteteve të rëndësishme, të cilat janë zhvilluar në koordinim me njësitë relevante policore dhe institucionet përkatëse, duke garantuar sigurinë personale dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve zyrtare.

Në fushën e sigurisë në trafikun rrugor, janë ndërmarrë masa konkrete dhe të vazhdueshme, përfshirë:

- 319 shkresa zyrtare lidhur me çështje të sigurisë në trafik;
- 220 komunikata dhe përgjigje zyrtare ndaj kërkesave dhe pyetjeve në fushën e trafikut;
- 141 raporte analitike dhe krahasimore mbi aksidentet në trafikun rrugor;
- 133 inspektime nga Departamenti për Kontrollin e Rregullave Rrugore (DKRR) në njësitë e trafikut;
- 47 inspektime të infrastrukturës rrugore, me qëllim evidentimin e mangësive dhe adresimin e tyre tek autoritetet kompetente.

Në kuadër të masave parandaluese dhe vetëdijesuese, janë realizuar **83** aktivitete vetëdijesuese dhe ligjërata në institucionet arsimore, si dhe **20** trajnime profesionale brenda vendit për zyrtarët policorë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve operative dhe profesionale.

Gjatë vitit raportues janë zhvilluar **79** takime zyrtare dhe koordinuese, janë hartuar dhe janë zbatuar **68** urdhra, plane operative dhe aktivitete të task-forcave, si dhe janë funksionalizuar **53** komisione për projekte policore, në përputhje me procedurat e brendshme dhe aktet normative të Policisë.

Në drejtim të zbatimit të legjislacionit në trafikun rrugor, gjatë vitit 2025 janë shqiptuar gjithsej **785,107** tiketa për kundërvajtje në trafik, që paraqet një rritje prej 8.30% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si rezultat i intensifikimit të kontrolleve dhe veprimeve policore.

Statistikat e aksidenteve në trafikun rrugor për vitin 2025 tregojnë:

- rritje të numrit të përgjithshëm të aksidenteve nga 22,604 në 24,150, apo 6.83%;
- rritje të aksidenteve me pasoja fatale nga 89 në 100, apo 12.35%;
- rritje të aksidenteve me lëndime nga 8,147 në 8,842, apo 8.53%;
- rritje të aksidenteve me dëme materiale nga 14,368 në 15,208, apo 5.84%;
- 111 persona kanë humbur jetën, që paraqet rritje prej 14.43%;
- 16,681 persona janë lënduar, apo rritje prej 9.10%, krahasuar me vitin 2024.

Këto të dhëna vënë në pah nevojën për vazhdimin e zbatimit të masave operative, parandaluese dhe ndëshkuese, si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional në funksion të përmirësimit të sigurisë në trafikun rrugor.

Sa i përket veprimtarisë së Komisionit për Vendosje, lidhur me kundërshtimet ndaj kundërvajtjeve të shqiptuara nga Policia, gjatë vitit 2025 janë evidentuar 14,831 kundërshtime (ankesa), janë zhvilluar 1,392 seanca shqyrtuese, si dhe janë nxjerrë 13,454 vendime, në përputhje me procedurat administrative dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Tabela nr.6: Komisioni për Vendosje

Komisioni për Vendosje	2024	2025	%
Kundërshtimet e pranuar	13728	14831	53.33
Seancat e mbajtura	965	1392	44.24
Kundërshtimet e shqyrtuara	8984	13454	49.75

Policimi në Bashkësi

Gjatë vitit 2025, Divizioni i Policimit në Bashkësi ka realizuar një gamë të gjerë aktiviteteve operative, koordinuese dhe parandaluese, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me komunitetin, rritjen e besimit të qytetarëve në Polici dhe parandalimin e veprave penale dhe dukurive negative.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit institucional, janë realizuar 199 takime të brendshme dhe 153 takime me institucione, organizata dhe organizata joqeveritare, si dhe 87 konferenca, tryeza dhe punëtori brenda vendit, përderisa 3 aktivitete të tilla janë realizuar jashtë vendit. Këto aktivitete kanë shërbyer për shkëmbim informacioni, koordinim të veprimeve dhe avancim të qasjeve preventive në Polici.

Drejtorja ka zhvilluar gjithashtu 17 vizita pune brenda vendit, në Drejtoritë Rajonale të Policisë dhe stacione policore, me qëllim monitorimin e zbatimit të politikave të policimit në bashkësi dhe ofrimin e mbështetjes profesionale.

Në aspektin e kontrollit dhe mbikëqyrjes, janë realizuar 48 inspektive, ndërsa në kuadër të Drejtorisë së Sigurimit të Trashëgimisë Kulturore (DSTK) janë zhvilluar gjithsej 6,634 inspektive, të cilat kanë pasur për qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e objekteve dhe pasurive të trashëgimisë kulturore, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat standarde operative.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale, janë realizuar 14 trajnime brenda vendit, 3 trajnime jashtë vendit dhe 1 pjesëmarrje në seminar, si dhe 53 ligjërata dhe prezantime, duke kontribuar në zhvillimin profesional të zyrtarëve policorë dhe partnerëve relevantë.

Në fushën e menaxhimit të projekteve, drejtoria ka realizuar 15 aktivitete të planifikimit dhe draftimit të projekteve, nga të cilat 14 projekte janë aprovuar dhe janë lansuar, duke kontribuar në avancimin e policimit në bashkësi dhe aktiviteteve preventive.

Sa i përket komunikimit me publikun dhe transparencës, janë përpiluar 53 raporte njoftuese me shkrim për media, si dhe janë realizuar 6 prezantime para mediave, me qëllim informimin e rregullt të opinionit publik për aktivitetet policore.

Po ashtu, janë adresuar dhe janë zgjidhur 9 raste të problemeve të identifikuara në komunitet, përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe institucionet lokale, duke reflektuar qasjen proaktive të policimit në bashkësi.

Në përfundim, aktivitetet e realizuara nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë gjatë vitit 2025 dëshmojnë angazhim të qëndrueshëm institucional në forcimin e partneritetit me komunitetin, parandalimin e dukurive negative dhe rritjen e sigurisë së përgjithshme.

Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit

Për periudhën raportuese, në kuadër të aktiviteteve policore të orientuara në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, krimit ekonomik dhe korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, është punuar në gjithsej **1,711** raste, prej tyre **1,046** raste të reja, **323** raste të pranuar nga njësitë e tjera në kuadër të Policisë së Kosovës, **342** raste janë bartur nga vitet paraprake. Sa i përket krahasimit të numrit të rasteve në punë me vitin 2024 tregon *ngritje* për **16.32%**.

Janë realizuar **316** operacione, që krahasuar me vitin 2024 tregon *ngritje* për **15.32%** dhe janë zbatuar **867** urdhër kontrolle/bastisje, që në krahasim me vitin 2024 tregon *ngritje* për **12.59%**.

Gjatë vitit 2025 janë arrestuar **1,515** persona të dyshuar për vepra të rënda penale, që krahasuar me vitin 2024 tregon *ngritje* për **31.96%**, ndërsa janë ndaluar **761** persona, që krahasuar me vitin 2024 tregon *ngritje* për **35.89%**.

Janë paraqitur **1,098** kallëzime penale, **67** prej të cilave me kryes të panjohur, **1031** kallëzime penale me kryes të njohur ndaj **1,948** personave, krahasuar me vitin 2024 kemi një *ngritje të kallëzimeve penale* për **6.39%**. Janë goditur **22** grupe kriminale që krahasuar me vitin 2024 tregon *rënie* për **21.42%**.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë vitit 2025 janë regjistruar **147** raste, janë arrestuar **259** persona të dyshuar dhe janë paraqitur **61** kallëzime penale ndaj **98** personave të dyshuar dhe **89** fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj **182** personave. Prej tyre, për: a) trafikim me njerëz - janë regjistruar **9** raste; b) mundësim prostitucioni - janë iniciuar **22** raste; c) marrje me prostitucion - janë regjistruar **91** raste dhe d) për vepra të tjera të kësaj natyre - janë identifikuar **7** viktima të trafikimit, **22** viktima potenciale për vepra tjera dhe janë asistuar **51** viktima të trafikimit.

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë janë iniciuar gjithsej **750** raste të reja, janë arrestuar **961** persona dhe janë paraqitur **581** kallëzime penale ndaj **827** të dyshuarve. Prej tyre, për: a) trafikim - janë regjistruar **261** raste, b) posedim të drogave - **406** raste, c) kultivim **25** raste dhe d) për vepra të tjera të kësaj natyre - **1** rast. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, për heroinë janë iniciuar **7** raste, për kokainë janë regjistruar **125** raste, për marihuanë janë iniciuar **553** raste, për kultivimin e bimëve të kanabisit janë iniciuar **21** raste ndërsa për droga të tjera janë regjistruar **4** raste.

Gjatë vitit 2025 janë konfiskuar **1 kg. 520.08 gr.** heroinë; **24 kg 404.86 gr.** kokainë; **1315 kg 869.1 gr.** marihuanë, **4 kg 525.14 gr.** ekstazi si dhe **6,587** bimë kanabis.

Në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit janë regjistruar **271** raste, janë arrestuar **116** të dyshuar dhe janë paraqitur **251** kallëzime penale ndaj **529** personave të dyshuar. Për veprën penale: a) kundër detyrës zyrtare/korrupsionit - janë regjistruar **130** raste; b) kundër ekonomisë - **33** raste; c) kundër pasurisë - **27** raste; d) falsifikim dhe mashtrim - **10** raste; dhe e) vepra të tjera janë regjistruar **33** raste.

Në fushën e hetimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda janë iniciuar **113** raste, janë arrestuar **129** persona të dyshuar dhe janë ngritur **85** kallëzime penale ndaj **169** të dyshuarve. Për veprën penale: a) krim i organizuar - janë regjistruar **3** raste; b) kontrabandim me armë - **8** raste; c) kontrabandim me migrantë – **1** rast; d) organizim i skemave piramidale - **2** raste; e) auto krime - **3** raste dhe f) kanosje - **38** raste; g) detyrim - **3** raste; i) organizim i skemave piramidale – **2** raste; j) fajde - **9** raste; k) vepra penale kundër rendit kushtetues - **1** rast; l) vrasje – **2** raste; si dhe ll) për vepra tjera të kësaj natyre janë regjistruar **43** raste.

Në fushën e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit - janë regjistruar **16** raste, janë arrestuar **9** persona të dyshuar dhe janë paraqitur **5** kallëzime penale ndaj **9** personave të dyshuar. Prej gjithsej **16** rasteve, **3** janë regjistruar në fushën e terrorizmit dhe **13** për vepra tjera.

Në fushën e hetimit të krimeve kibernetike - janë regjistruar **47** raste, janë arrestuar **30** persona të dyshuar dhe janë ngritur **27** kallëzime penale ndaj **35** personave të dyshuar.

Hetimi i krimeve të luftës - janë iniciuar **21** raste, janë arrestuar **10** persona dhe janë përcjellë **20** kallëzime penale ndaj **279** personave.

Njësia e Veçantë e Hetimeve ka iniciuar **4** raste kundër detyrës zyrtare, ka arrestuar **1** person dhe ka përcjellë **1** kallëzim penal ndaj **2** të dyshuarve.

Tabela nr.7: Veprat penale-Departamenti i Hetimeve

Vepra penale	2024	2025	%
Trafikim me narkotikë	201	276	37.31
Trafikim me njerëz	8	9	12.5
Kundër ekonomisë	23	33	43.47
Korrupsion	118	134	13.55
Fajde	7	9	28.57
Shpëlarje e parave	2	0	-100
Krim i organizuar	1	3	200
Veprat tjera të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	104	112	7.69

Tabela nr.8: Aktivitetet e Departamentit të Hetimeve

Kategoria	2024	2025	%
Operacione policore	274	316	15.32
Bastisje/lokale të kontrolluara	770	867	12.59
Grupe kriminale	28	22	-21.42
Kallëzime penale	965	1031	6.83

Kontrabandim me armë	8	8	0
Krime kibernetike	34	47	38.23
Terrorizëm	5	1	-80
Raste tjera të fushës së terrorizmit	18	13	-27.77
Krime lufte	15	21	40

Tabela nr.9: Asetet e ngrira/të sekuestruara

ASETET E NGRIRA/ TË SEKUESTRUARA	2024	2025	%
Shtëpi	1	8	700.00
Banesa	66	219	231.82
Lokale	4	37	825.00
Garazhe	30	204	580.00
Patundshmëri (toka)	29	569	1862.07
Ngrirje e xhirrollogarive	13	78	500.00
Vlera e përafërt e aseteve	10,045,609.94 €	120,979,972.14 €	1104.31

Tabela nr.10: Konfiskimet/sekuestrimet

KONFISKIME/SEKUESTRIME	2024	2025	%
Substancë narkotike (HEROINË)	27 kg 883.94g	1kg 520.08g	-94.55%
Substancë narkotike (KOKAINË)	14 kg 099.32g	24kg 404.86g	73.09%
Substancë narkotike (MARIHUANË)	1279kg 844.85g	1315kg 869.10g	2.81%
Ekstazi (gramë)	3 kg 791.2g	4kg 525.14g	19.36%
Amfetamin/Methamph.-Speed (gramë)	415.99g	16.21	-93.10%
Substanca narkotike (bimë kanabisi)	7,126	6,587	-7.56%
Substanca narkotike (fara kanabisi - gramë)	26.5g	676.6	2453.21%
Substanca tjera	362 kg 090.51g	28 kg 539.59g	-92.12%
Armë	109	199	82.57%
Municion	5543	9639	73.90%
Euro	2,534,004.57	1,888,010.75	-28.70%
Dollarë	148.236	855.00	-99.42%
Franga - CHF	34,420	512.00	-85.12%
Lekë	10,650	84,200.00	690.61%
Vetura	117	213	82.05%

Kontrolli, mbikëqyrja dhe menaxhimi i integruar i kufirit

Policia është e përkushtuar për të mbrojtur kufijtë e vendit kundër një sërë kërcënimesh, duke përfshirë emigracionin e paligjshëm, trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën e drogës dhe armëve si dhe terrorizmin. Roli i Policisë në kontrollin kufitar është i shumanshëm, duke përfshirë jo vetëm patrullimet dhe kontrollet fizike, por edhe mbledhjen e inteligjencës, vlerësimin e rrezikut dhe zbatimin e strategjive proaktive për parandalimin e krimit. Policia punon ngushtë me doganat dhe agjenci të tjera, për të monitoruar dhe për të siguruar kufijtë dhe për të parandaluar aktivitetet e paligjshme.

Si rezultat i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të autoriteteve të MIK-ut, kufijtë e Republikës së Kosovës i kanë kaluar **34,500,561** persona, që krahasuar me vitin e kaluar tregon *ngritje* për **13.10%**; **10,308,344** mjete motorike, që tregon *ngritje* për **16.82%** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa *rënie* për **100%** e trenave.

Tabela nr.11: Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit

Kategoria	2024	2025	%
Hyrje/dalje të personave në kufi	30503299	34500561	13.10
Mjete motorike të kaluara në kufi	8823558	10308344	16.82
Refuzim të hyrjes në RKS	3166	4424	39.73
Refuzim të daljes nga RKS	648	697	7.56
Gjoha për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve	1054	1029	-2.37
Persona të kontrolluar në vijën e dytë	35941	41795	16.28

Në kuadër të kontrollit të hyrje-daljeve të personave në pikat kufitare janë evidentuar dhe janë procesuar **8,281** persona të rëndësishëm (VIP).

Gjatë ofrimit të sigurisë së kufijve të Republikës së Kosovës, si rezultat i shkeljeve të ndryshme ligjore, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë hapur **692** raste të veprave penale, **557** kundërvajtje, kanë shqiptuar **1,029** gjoha për kundërvajtje në fushën e migrimit dhe të huajve. Policia Kufitare ka arrestuar **688** persona për vepra të ndryshme kriminale, **1,976** persona me urdhëresa vendore, **2** persona me urdhëresa të ndryshme (ndërkombëtare etj.) dhe ka ndaluar **62** persona.

Tabela nr. 12: Aktivitetet e Policisë Kufitare

Kategoritë	2024	2025	%
Veprat penale	520	692	33.08
Kundërvajtjet	246	557	126.42
Personat e arrestuar	589	688	16.81
Personat e arrestuar me urdhëresë	1939	1978	2.01
Armë zjarri të konfiskuara	100	75	-25.00
Municion (copë)	3707	1763	-52.44

Me qëllim të përmbushjes së objektivave të parapara për periudhën raportuese, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë bërë **1,246** inspektime në fushën e migrimit të të huajve, **4,424** refuzime të hyrjes, **697** refuzime të daljes, si dhe kanë realizuar **993** verifikime të kërkesave për viza të Republikës së Kosovës. Po ashtu, zyrtarët e Policisë Kufitare kanë ekzekutuar **53** depërtime, **63** urdhërlargime me forcë, **479** urdhërlargime vullnetare dhe kanë trajtuar **173** kërkesa për azilkërkues.

Tabela nr.13: Aktivitetet në bazë të Ligjit për të huaj

Aktivitetet	2024	2025	%
Inspektime	1160	1246	7.14
Depërtime të ekzekutuara me vendim gjykatë	39	53	35.89
Vendime për largim me forcë	36	63	75
Vendime për largime vullnetare	454	479	5.5
Azilkërkues	188	173	-7.97
Vërtetim për akomodim në qendrën e pritjes në Vranidoll	853	867	1.64

Policia Kufitare gjatë kësaj periudhe ka realizuar **65** operacione dhe **439** patrullime të përbashkëta me shtetet fqinje (Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi). Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit janë realizuar: **82** takime të punës brenda Policisë, **51** takime me autoritetet e MIK-ut, ndërsa **93** aktivitete kanë qenë me karakter ndërkombëtar.

Tabela nr.14: Rastet në bazë të Ligjit për të huaj

Rastet	2024	2025	%
Qëndrim i paligjshëm	216	240	11.11
Gjoha të shqiptuara për kompani	90	55	-38.88
Shtetas të trajtuar me aplikacion për mbrojtje të përkohshme-refugjatë	67	1	-98.5

Tabela nr.15: Aktivitete me rëndësi në kuadër të DPK

Veprat penale sipas kompetencës	2024	2025	%
Kalim i paautorizuar i kufirit	115	125	8.69
Kontrabandë me emigrantë	11	11	0
Posedim i paligjshëm i armëve	41	68	65.85
Kontrabandë me mallra	89	61	-31.46
Falsifikimi i dokumentit	39	26	-33.33

Burimet njerëzore

Policia e Kosovës, aktualisht përbëhet nga **9,871** punonjës, prej të cilëve **9,037** janë zyrtarë policorë, ndërsa **834** staf civil. Nga ky numër **84.78%** e personelit të Policisë i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa **15.22%** gjinisë femërore, prej të cilëve **90.10%** janë shqiptarë, ndërsa **9.90%** iu takojnë komuniteteve tjera.

Tabela nr.16: Krahasimi i përfaqësimit Polici/Popullsi

Krahasimi i përfaqësimit Polici/popullsi	Shqiptarë	Serbë	Boshnjakë	Turq	Romë	Ashkalinj	Egjiptianë	Goranë	Të tjerë	Totali i popullsisë dhe i të punësuarave në Polici për vitin 2025
Popullsi	1454999	53021	27152	19419	8730	16207	10581	9140	3266	1602515
Të punësuar në Polici gjatë vitit 2025	8894	540	231	90	18	29	24	38	7	9871
Totali i % në popullatë	90.79%	3.31%	1.69%	1.21%	0.54%	1.01%	0.66%	0.57%	0.20%	
Totali i % në Polici	90.10%	5.47%	2.34%	0.91%	0.18%	0.24%	0.27%	0.38%	0.07%	
Diferenca	-0.69%	2.16%	0.65%	-0.30%	-0.36%	-0.72%	-0.42%	-0.19%	-0.13%	

Vazhdimësia e Policisë është thelbësore për ruajtjen e një sistemi të qëndrueshëm, efektiv dhe profesional të zbatimit të ligjit. Policia është e përkushtuar për të garantuar suksesin e saj afatgjatë dhe efikasitetin operacional, duke investuar vazhdimisht në personelin dhe infrastrukturën e saj.

Gjithsej, gjatë këtij viti janë punësuar **283** zyrtarë, prej tyre **281** meshkuj dhe **2** femra, 79.40% më pak se në vitin 2024.

Tabela nr.17: Krahasimi i të punësuarve në PK për 2024/2025

Të punësuar	Viti 2024			Viti 2025			Krahasimi
	Civil	Uniformë	Gjithsej	Civil	Uniformë	Gjithsej	
Shqiptarë	27	1158	1185	29	264	293	-892
Serbë	1	120	121		11	11	-110
Boshnjakë		53	53		4	4	-49
Turq		15	15	1	1	2	-13
Egjiptianë		14	14		2	2	-12
Ashkalinj		9	9		1	1	-8
Romë		5	5				-5
Goranë				1		1	1
Gjithsej	28	1374	1402	31	283	314	-1088

Është zhvilluar kampanjë sensibilizuese në të gjitha drejtoritë rajonale për rritjen e numrit të aplikantëve për zyrtarë policorë dhe janë realizuar fazat kryesore të rekrutimit (testi me shkrim, testi fizik, intervistat), ndërsa procesi vazhdon me testimin psikologjik dhe mjekësor.

Janë modifikuar dhe janë aprovuar Procedura Standarde të Operimit (PSO) për angazhimin jashtë detyrës zyrtare, punën dytësore, si dhe për rekrutimin dhe seleksionimin.

Është hartuar dhe është aprovuar katalogu i vendeve të punës për stafin civil dhe është aprovuar PSO për Sistemin e Menaxhimit të Informatave të Resurseve (SMIR).

Është përmbyllur procesi i rekrutimit për Gjeneratën 62, me nënshkrimin e kontratave dhe fillimin e trajnimit për 283 kandidatë.

Tabela nr.18: Ndryshimet e personelit

Kategoria	2024		Gjithsej	2025		Gjithsej	%
	Zyrtar policor	Staf civil		Zyrtar policor	Staf civil		
Dorëheqjet	88	8	96	82	10	92	-4,17
Pensionimi	135	19	154	141	22	163	5,84
Vdekjet	22	3	25	21	3	24	-4,00
Ndërprerje e marrëdhënies së punës	21	1	22	56	2	58	163,64
TOTALI	266	31	297	300	37	337	13,47

Gjatë vitit 2025, Policia e Kosovës ka vazhduar të zhvillojë kapacitetet e zyrtarëve të saj përmes 1,252 aktiviteteve trajnuese me gjithsej 11,829 pjesëmarrës. Fokus i veçantë ka qenë ricertifikimi, trajnimi i specializuar dhe pjesëmarrja në seminare dhe konferenca ndërkombëtare. Ky angazhim i vazhdueshëm nxit forcimin e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të Policisë dhe rrit bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Po ashtu në proces është edhe studimi në Fakultetin e Sigurisë Publike me pjesëmarrjen e studentëve për 4 vitet akademike.

Tabela nr.19: Trajnimet e realizuara gjatë vitit 2025 dhe krahasimi me vitin 2024

Aktivitetet	2024		2025		Përqindja e trajnimeve
	Trajnime	Pjesëmarrës	Trajnime	Pjesëmarrës	
Trajnimet e realizuara nga Divizioni i Trajnimeve	400	9335	220	4033	-45
Ricertifikimi	128	1709	231	2775	80.46
Trajnimet e realizuara nga organizatat tjera në bashkëpunim me Divizionin e Trajnimeve	490	5237	420	3994	-14.28
Trajnime për organizata të tjera	9	289	10	114	11.11
Trajnimet, seminarët dhe konferencat e mbajtura jashtë vendit	403	1036	371	913	-7.94
Gjithsej	1430	17606	1252	11829	-12.44

Për të vlerësuar punën e palodhur, përkushtimin dhe shërbimin profesional të punonjësve të Policisë, si dhe për të motivuar vazhdimin e performancës në përputhje me standardet më të larta të shërbimit, për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, janë ndarë shpërblime dhe vlerësime për punonjësit e Policisë.

Në këtë kuadër, janë dhënë:

- 4 Medalje për Shërbim të Dalluar, për kontribut të veçantë në shërbim;
- 28 Medalje Policore për Lëvdim, si njohje për arritje dhe performancë të lartë;
- 26 Lëvdata, për angazhime të spikatura në detyrë;
- 9 mirënjohje, për kontribut të veçantë në projekte dhe aktivitete specifike;
- 521 shpërblime për Shërbim të Besnikërisë, si njohje për vazhdimësinë dhe përkushtimin në detyrë.

Përkushtimi profesional i zyrtarëve policorë në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve të shtetit kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme të shëndetit fizik dhe mendor. Në këtë drejtim, Policia e Kosovës i kushton rëndësi të veçantë mirëqenies së pjesëtarëve të saj, si element kyç për ruajtjen e gatishmërisë operative dhe sigurisë në punë.

Gjatë vitit raportues, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore (DShSh), janë realizuar aktivitete të shumta në fushën e ekzaminimeve mjekësore dhe psikologjike, përkrahjes shëndetësore, menaxhimit të lëndimeve dhe sëmundjeve në detyrë, si dhe fuqizimit të mirëqenies mendore. Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut është realizuar kampanja e dhurimit të gjakut me gjithsej 1,419 dhurues, ndërsa ekipi mjekësor i DShSh-së me autoambulancë ka qenë i angazhuar në 67 urdhra operativë/asistenca. Gjithashtu, janë mbajtur ligjërata tematike shëndetësore dhe është pranuar donacion prej 11 defibrilatorësh profesionalë nga misioni i OSBE-së.

Ekzaminime mjekësore dhe psikologjike:

- 661 ekzaminime periodike (DNJS)
- 128 ekzaminime periodike (DMA)
- 87 ekzaminime (NJMA)
- 425 ekzaminime për aplikantë të PK-së
- 77 ekzaminime për aplikantë të NJSO-së
- 714 testime psikologjike
- 34 rivlerësime psikologjike

Shërbimet mbështetëse

Për të përmbushur të gjitha këto obligime me sukses, Policia e Kosovës, për vitin 2025 ka pasur në dispozicion buxhetin prej **172,640,823.36€**, të cilin e ka realizuar në masë prej **98.66%**.

Tabela nr.22: Kategoritë e shpenzimeve ekonomike

Kategoritë ekonomike	Buxheti 2025	Buxheti 2024	Ndryshimi	Shprehur në %
	A	B	C=A-B	D=(A/B)-100%
Pagat dhe shtesat	128,165,980.82	114,417,829.96	13,748,150.86 €	12.02%
Mallrat dhe shërbimet	19,166,703.16	22,718,542.65	(3,551,839.49 €)	-15.63%
Shpenzimet kapitale	22,127,247.00	29,482,620.00	(7,355,373.00 €)	-24.95%
Shpenzimet komunale	1,360,250.00	1,360,250.00	0.00 €	0.00%
Subvencionet dhe transferet	1,820,642.38	1,668,610.41	152,031.97 €	9.11%
TOTALI	172,640,823.36 €	169,647,853.02 €	2,992,970.34 €	1.76%

Shuma e përgjithshme e të hyrave për këtë periudhë kohore ka qenë **28,876,334.06€** prej tyre **24,545,003.67€** nga gjobat në trafik.

Gjatë vitit 2025 janë nënshkruar 112 kontrata, prej tyre: a) 101 për furnizime; b) 25 për shërbime; c) 21 për punë.

Gjatë vitit 2025 janë përfunduar disa projekte të ndërtimit si: a) Stacioni Policor – Hani i Elezit; b) objekti i garazhit në QNJS “Enver Zymeri”, ndërsa në ndërtim e sipër janë: a) aneksi-qendrat e ndalimit-SP Qendër; b) SP Zubin Potok; c) ndërtimi i objektit SP Fushë Kosovë & ARC – në proces të nënshkrimit të kontratës depo në QNJS “Enver Zymeri”.

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (DTIK) ka realizuar avancime të rëndësishme në modernizimin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës teknologjike të Policisë së Kosovës. Investimet dhe zhvillimet e realizuara kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit operacional, sigurisë kibernetike dhe mbështetjes teknike për të gjitha strukturat policore.

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (DTIK) ka realizuar avancime të rëndësishme në modernizimin e infrastrukturës teknologjike të Policisë, duke forcuar sigurinë, stabilitetin dhe efikasitetin operacional.

Po ashtu, është siguruar mbështetje logjistike për të gjitha nivelet e PK-së, me qëllim të realizimit të aktiviteteve operative dhe administrative Policia është furnizuar me armë të gjata të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm, me automjete patrulluese dhe automjete civile, me kombi të ndryshëm, me automjete të blinduara, autoblanda, me pajisje - smart patrulla (pajisje të mençura për trafik), me radar të avancuar për matje të shpejtësisë dhe me pajisje tjera të veçanta/speciale për njësitë e specializuara.

Është realizuar furnizimi me **156** automjete të reja ku prej tyre janë:

- **49** vetura civile;
- **56** vetura zyrtare;
- **23** kombi;
- **5** pikap;
- **23** xhipa.

Në përputhje me misionin e saj, Policia është e përkushtuar të rrisë kapacitetet, duke zbatuar teknologji të avancuara që mbështesin operacionet e policisë, forcojnë masat e sigurisë dhe drejtojnë proceset e përgjithshme, për të lehtësuar aktivitetet më efikase të zbatimit të ligjit.

Disiplina dhe kontrolli i brendshëm

Policia monitoron, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve të saj, për të siguruar llogaridhënie dhe profesionalizëm. Si rezultat i këtij kontrolli të brendshëm, sjelljet e pahijshme identifikohen dhe adresohen, duke siguruar që policët t'iu përmbahen standardeve etike dhe të ruajnë besimin e publikut në zbatimin e ligjit.

Si rezultat i kësaj kontrole të brendshme gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës ka administruar **1,025** lëndë disiplinore, prej tyre **743** lëndë të hapura gjatë vitit 2025 dhe **282** lëndë të bartura nga vitet paraprake. Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar gjithsej **741** lëndë, prej të cilave **311** kanë qenë të bazuara dhe **430** të pabazuara/të paargumentuara.

Në Komisionin e Brendshëm Disiplinor janë pranuar **311** lëndë dhe janë shqyrtuar **303** lëndë. Janë nxjerrë **458** vendime disiplinore, nga të cilat: **18** raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; **1** rast degradim- jo

më shumë se një gradë; **156** raste ndalesë në pagë mujore bruto për shkelje të rëndë; **6** transfere disiplinore; **56** raste ndalesë në pagë mujore bruto për shkelje të lehtë; **69** vërejtje me shkrim; **23** vërejtje me gojë; **3** raste, është përgjegjës për shkelje disiplinore dhe lirohet nga shqiptimi i masës disiplinore.

Komisioni i Ankesave ka pranuar **501** ankesa, ndërsa ka shqyrtuar **503** ankesa, prej të cilave: **386** ankesa janë refuzuar, **21** ankesa të aprovuara, **59** ankesa kanë qenë pjesërisht të aprovuara, **13** lëndë janë kthyer në plotësim të hetimeve/rishqyrtim dhe rivendosi, ndërsa **25** ankesa janë hedhur poshtë, pasi që janë parashtruar jashtë afatit, është tërhequr nga ankuesja, i pabazuar apo ankesa nuk ka përmbajtur arsye të mjaftueshme.

Kontrolli i brendshëm i Policisë është fuqizuar edhe me auditimet dhe inspektimet e brendshme. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Auditimit në kuadër të Policisë ka realizuar **12** auditime të rregullta, nga të cilat kanë rezultuar **55** rekomandime. Auditimet janë fokusuar në proceset kryesore financiare, administrative dhe operative, përfshirë shpenzimin e buxhetit, prokurimin publik, administrimin e kontratave, menaxhimin e pasurisë dhe pajisjeve, sistemimin dhe pagat e personelit policor, si dhe administrimin e kundërvajtjeve të trafikut. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit institucional të Policisë së Kosovës.

Në kuadër të inspektimeve të brendshme, Policia ka realizuar gjithsej 27 inspektime të rregullta dhe 23 inspektime të jashtëzakonshme, duke mbuluar të gjitha fushat e inspektimit të punës policore. Inspektimet janë fokusuar në zbatimin e objektivave të Strategjisë së Policimit të Drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi (2021–2025), menaxhimin e dhomave të dëshmitë, si dhe sigurimin e objekteve shtetërore, rezidenciale, diplomatike dhe të trashëgimisë kulturore.

Përveç inspektimeve të rregullta, janë realizuar inspektime të jashtëzakonshme, në fushat e përdorimit të automjeteve policore, menaxhimit dhe zbatimit të urdhërësive të gjykatave, si dhe zbatimit të rregullave të brendshme dhe standardeve të disiplinës dhe profesionalizmit.

Bashkëpunimi me publikun - mediat

Komunikimi efektiv dhe transparent me publikun dhe mediat përbën një komponent të rëndësishëm të funksionimit institucional të Policisë së Kosovës. Përmes Drejtorisë për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (DIMP), Policia siguron informim të rregullt, të saktë dhe të koordinuar lidhur me aktivitetet dhe angazhimet policore, duke kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besimit publik.

Gjatë periudhës njëvjeçare, DIMP ka realizuar detyrat e planifikuara si dhe një numër të madh aktiviteteesh të paplanifikuara, duke përfshirë prononcime publike, konferenca, debate dhe përgjigje ndaj mijëra kërkesave nga mediat dhe palët e interesuara, përfshirë kërkesat për qasje në dokumente publike. Është realizuar raportimi ditor 24-orësh i Policisë së Kosovës dhe monitorimi i përditshëm i mediave.

Në nivel qendror gjatë vitit janë publikuar 260 komunikata, sqarime dhe reagime për media, janë organizuar 8 konferenca për media, si dhe janë regjistruar gjithsej 1,669 aktivitete policore. DIMP ka avancuar projekte strategjike në fushën e komunikimit publik, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me RTK-në, ka kontribuar në përmirësimin e moduleve trajnuese për komunikim me media dhe ka publikuar një numër të revistës “Mbrojtësi”.

Tabela nr.23: Aktivitetet e mediave

Mediat elektronike dhe të shkruara	2024	2025	%
Komunikata me shkrim për media	1775	1964	10.64
Raporte 24-orëshe	365	365	0
Aktivite, fotolajme, dokumente të ndryshme policore në rrjetet sociale	2567	1669	-34.98
Kërkesa për qasje në dokumente publike të trajtuara	133	184	38.34
Konferenca për shtyp dhe intervista në nivel qendror	20	8	-60
Të dizajnuara dhe të publikuara, dokumente të ndryshme (plane, fushata vetëdijesuese, posterë etj.).	76	65	-14.47

Sfidat e Policisë

Gjatë kryerjes së detyrave të saj, Policia e Kosovës përballlet me disa sfida të vazhdueshme, duke përfshirë:

- Mosanëtarësimi në INTERPOL dhe organizata të tjera ndërkombëtare të sigurisë, duke kufizuar bashkëpunimin e tij global dhe aftësitë e shkëmbimit të informacionit.
- Shqetësimet e sigurisë në rajonet veriore të vendit, që paraqesin sfida operacionale dhe të stabilitetit.
- Forca e vjetër e Policisë, e cila paraqet sfida për sa i përket përvojës kundrejt kërkesave fizike.
- Kërcënimet hibride, të tilla si sulmet kibernetike dhe dezinformatat, duke komplikuar përpjekjet për të ruajtur sigurinë dhe besimin e publikut.

Objektivat strategjike për vitin 2026

Objektivi 1 - fuqizimi i sigurisë publike, hetimit të krimit dhe sigurisë kufitare

Objektivi 2 - avancimi i kapaciteteve në fushën e parandalimit për forcimin e qasjes proaktive policore

Objektivi 3 - reformimi i burimeve njerëzore, ngritja e kapaciteteve, forcimi i disiplinës dhe integritetit


Objektivi 4 - modernizimi dhe digjitalizimi i organizatës, zhvillimi i infrastrukturës, pajisjeve dhe teknologjisë

Prioritetet për vitin 2026

- Menaxhimi i situatës së sigurisë në veri të vendit, për të garantuar stabilitet dhe paqe;
- Rritja e parandalimit të krimit dhe sigurisë në trafik, duke u fokusuar në uljen e aktivitetit kriminal dhe përmirësimin e sigurisë rrugore;
- Forcimi i hetimit dhe luftës kundër veprave penale, duke përfshirë trafikun e drogës, korrupsionin, krimin kibernetik dhe krimet e luftës;
- Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërinstytucional, për të përmirësuar sigurinë dhe shkëmbimin e informacionit me rëndësi;
- Përmirësimi i mirëqenies së punonjësve të Policisë së Kosovës, sigurimi i kushteve më të mira të punës dhe mbështetje për policët;
- Investimi në modernizimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të PK-së, digjitalizimi, përmirësimi i pajisjeve, mjeteve të punës dhe objekteve për operime më efikase;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimit të avancuar në fusha të specializuara për të ndërtuar një fuqi punëtore më të aftë.



Aplikacioni "Lajmëro Policinë – i ridizajnuar dhe tani edhe në iOS dhe Android



Tani në Android & iOS



Get it on
Google Play



Download on the
App Store